

Neni 29

Administrata e ADISA-s

1.Rekrutimi i nëpunësve të ADISA-s bëhet në bazë të kërkesave dhe përshkrimeve të punës, të përcaktuara në rregulloren e brendshme. Procedurat e rekrutimit duhet të jenë transparente dhe jodiskriminuese, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi për funksionimin e administratës. Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e ADISA-s rregullohen sipas Kodit të Punës.

2.Nuk mund të punësohen në strukturat e ADISA-s personat:

a)ortakë apo aksionarë të subjekteve të mbikëqyrura;

b)që kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën “b”, të kësaj pike, me anëtarët e Këshillit Drejtues ose me punonjës të tjerë të administratës, me të cilët kanë lidhje varësie;

c)e dënuar me vendim gjykate të formës së prerë; ç) që nuk gëzojnë integritet moral dhe profesional;

d)për të cilët është marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil.